



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:238450

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06495133

P.nr.2023:238451

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Adem Shabani dhe zyrtarja ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit Xh.Z. me vendbanim në fshatin S. Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së (Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074), në bazë të aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departament i Përgjithshëm, PP/II.nr.1540/2023 të datës 03.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datën 20.08 2024, dhe vazhduar me datën 01.10.2024, dhe me datë 29.10.2024, me pjesëmarrjen e prokurori i shtetit Sadat Topalli, të dëmtuarit M.R. i pandehuri Xh.Z. dhe mbrojtësi i tj me autorizim Av. Besmir Rrahmani, me datën 01.11.2024 mori dhe shpalli ndërsa me datën 22.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

Xh.Z. me vendbanim në fshatin S., Komuna e Ferizajt, i lindur më në fshatin R., Komuna Ferizaj nga i ati I. dhe e ëma B., e gjinisë B. shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mirë ekonomike, ka të kryer Fakultetin me profesion ekonomist, kryesues iK.K. Ferizaj, me numër personal:.....

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP-së:

LIROHET NGA AKUZA

- Se me datë rreth orës, në rrugën në Ferizaj, saktësisht para objektit Komunal në Ferizaj, i pandehuri pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin M.R. lidhur me punësim e një personi i quajtur A.G. anëtar i partisë së të pandehurit, në atë mënyrë që i dëmtuari i'u kishte drejtuar me fjalët “a jeni në dijeni se është punësuar anëtari i partisë suaj A.G. në ndërmarrjen NPLnë kundërshtim me ligjin”, ashtu që i pandehuri me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit i drejtohet me zë të lartë duke përdorur fjalë me përmbajtje kërcënuese “ti je m..., dhe ty duhet me të vra”, me ç’ rast tek i dëmtuari ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe pasiguri,-

- **Me këtë kishte për të kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së.**

- I dëmtuari M.R. me adresë të banimit në rrugënP. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr..... të datës 03.11.2023, kundër të pandehurit Xh.Z., me vendbanim në fshatin S., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së

Gjykata, me datën 26.01.2024, duke vepruar rreth kësaj çështje penale, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ku i pandehuri Xh.Z., nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohet.

Pasi që i pandehuri në fillim të shqyrtimit fillestar për veprën penale që akuzohet nuk e ka pranuar fajësinë konform nenit 240 paragrafi 7 nën par 7.1 dhe 7.2 të KPPRK-së (Kodi nr.08/L-032) e informon të pandehurin dhe avokatin mbrojtës që ata mund të paraqesin propozimet e mëposhtme deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar: 7.1. çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të këtij Kodi; dhe 7.2. çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës në pajtim me nenin 244 paragrafit 1 të KPPRK-së (Kodi i Procedurës Penale nr.08/L-032).

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me datën 14.02.2024, mbrojtësi i të pandehurit Xh.Z. me autorizim Av. Naim Feriati, në afatin ligjor ka paraqitur Kërkesë për hedhje të

aktakuzës PP/II.nr.1540/2023 të datës 03.11.2023 dhe kundërshtimin e provave kundër të pandehurit Xh.Z. për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata me datën 12.03.2024, pas analizës së kërkesës për hedhjen e aktakuzës duke vepruar konform dispozitave të nenit 244 paragrafi 3 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale nr.08/L-032), ka sjell Aktvendim ku ka refuzuar në këtë fazë të procedurës kërkesën e për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave pasi që në seancat e shqyrtimeve gjyqësore do ti i pet mundësia e vlerësimit më të detajuar të pretendimeve të pandehurit dhe mbrojtëses të tij duke mos prej dikuar epilogun përfundimtar të këtij gjykimi.

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me datën 19.03.2024, në afatin ligjor mbrojtësi i të pandehurit Xh.Z. me autorizim Av. Naim Ferati ka paraqitur Ankesë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër Aktvendimit P.nr..... të datës 12.03.2024, lidhur me refuzimin e kërkesës për hudhje të aktakuzës të P.TH. Ferizaj PP/II.nr..... të datës 03.11.2023, kundër të pandehurit Xh.Z. për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit Kosovës duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të pandehurit Xh.Z. me autorizim Av. Naim Ferati e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore të Ferizaj P.nr..... të datës 12.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën, ka sjellë Aktvendim ku ka Refuzuar si të pa bazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit Xh.Z. me autorizim Av. Naim Ferati, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr..... të datës 12.03.2024, Vërtetohet në bazë të Aktvendimit PN..... datë 05.04.2024.

Gjykata në vazhdim duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimet gjyqësore publike më datë 20.08.2024, dhe vazhduar me datën 01.10.2024 dhe me datën 29.10.2024, në prani të prokurorit të shtetit, të dëmtuarit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij me autorizim avokatit.

Në fillim të shqyrtimeve gjyqësore, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat dhe detyrimet e tij në kuptim të nenin 319 par. 1 dhe 2 të KPP-së, (Kodi nr.08/L032), pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 321 paragrafi 1 të KPP-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar i pandehuri Xh.Z. me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij për veprën penale për të cilën është akuzuar,

në shqyrtimet gjyqësore ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet.

Pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 324 të KPP-së, (Kodi nr.08/L-032), ka kërkuar nga prokurori i shtetit , i dëmtuari mbrojtësi i të pandehurit dhe i pandehuri për të përmbledhur provat që mbështesin rastin apo kërkesën e tyre, ku palët kanë paraqitur fjalën hyrëse.

Prokurori i shtetit Sadat Topalli në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konform dispozitave të nenit 351 të KPPK-së, paraqes fjalën përfundimtare ku mbetem në tërësi pranë aktakuzën dhe kualifikimit juridik për veprën penale kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë prezantuar provat materiale dhe personale nga të cilat prova është vërtetuar se në ditën kritike me datë 31.08.2023. rreth orës 12, pranë hyrjes së Kuvendit Komunal në Ferizaj, është takuar i akuzuari me të dëmtuarin ku gjatë bisedës kanë shkëmbyer disa fjalë lidhur me shkeljet ligjore për emërimin e krye shefit të ndërmarrjes publike “Ambienti” dhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë i dëmtuari se si është zhvilluar biseda dhe si i dëmtuari e ka ofenduar dhe iu ka drejtuar me fjalët se ti je m... dhe ty duhet me të vra, gjithashtu gjatë shqyrtimeve gjyqësorë janë dëgjuar edhe tre dëshmitarë të cilët kanë treguar rastin e datës 31.08.2023, por të njëjtit e kanë shpjeguar se si janë takuar dhe si është zhvilluar biseda në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, por e kanë mohuar faktin se i pandehuri e ka kanosur me fjalët e cekura në dispozitivin e kësaj aktakuze, andaj i propozoj Gjykatës që deklarimeve të njëjta të mos ia fal besimin në tërësi pasi që të njëjtit janë anëtarë të subjekteve politike të cilët janë të përfaqësuar në asamblenë komunale në F.....dhe se i pandehuri është kryesues i kuvendit, gjithashtu këtë shqyrtim gjyqësorë, pasi që i dëmtuari propozoj që të shikohet një video incizim i sigluara në jutube, në kohën dhe vendin e përshkruar në dispozitivin e kësaj akuze, aty shihet debati në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit dhe vërtetohen pretendimet e të dëmtuarit, andaj propozoj Gjykatës që në bazë të cekurave më lartë, që gjatë marrjes së vendimit të këtë për bazë rrethanat rënduese dhe lehtësuese të paraparë me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së. Andaj propozoj gjykatës që ndaj të njëjtit të i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me ligj.

I dëmtuari M.R. në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështes deklarimin e prokurorit të shtetit, i bashkëngjitëm ndjekjes penale ndaj të pandehurit po ashtu edhe paraqes kërkesë pasurore juridike të cilën nuk e kam të precizuar, ashtu që e vërteta ka qenë se unë e kam pyetur të pandehurin se a je në dijeni për punësimin e aktivistit të AAK-së, e i njëjti ka filluar të më ofendojë e pastaj të më kanosë, e njoftoj Gjykatën se ne si organizatë qeveritare kemi përcjellë punën monitoruese të konkurseve në komunë dhe personi që është zgjedhur ka qenë

më herët o siguruar, e për këtë e kemi informuar edhe prokurorinë lidhur me rastin, inatet e të pandehurit nuk janë vetëm për këtë rast, sepse ne kemi hulumtuar dhe një drejtoreshë të tij, njoftojë se nga ky rast ka pas edhe kërcënime të tjera ku jam kërcënuar direkt nga personi që është prezent Xh.Z. pasi që i kam monitoruar ndërmarrjet që i menaxhon i pandehuri, ku edhe në video shihet se edhe në raste tjera jam kanosur dhe me urdhër të tij jam larguar nga puna, duke pas parasysh nga personi që është prezent nga veprimet e tij unë e ndiej veten të rrezikuar, gjithashtu dëshmitarët kanë pas ndikim në deklarata e tyre dhe kërkojë nga Gjykata që për veprën penale të shpallet fajtorë i pandehuri.

Mbrojtësi i të pandehurit Xh.Z., av. Besmir Rrahmani, fjalën përfundimtare e ka dorëzuar me shkrim nga një ekzemplarë, gjykatës, prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit të cilën edhe me gojë e ka elaboruar ku ka theksuar se lidhur me këtë, mbrojtja parashtron tezën e saj se aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me të cilën akuzohet i pandehuri për kryerjen e veprës penale nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, në lidhje me supozimin për dyshimet e bazuara mirë që pretendon organi i akuzës, konsiderojmë se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, përpos se nuk është vërtetuar gjendja faktike në proporcion me përshkrimin që i është dhënë nga ana e prokurorisë, tutje edhe përgjegjësia penale e cila i ngarkohet nga e njëjta, është e përcaktuar me ligj, dhe e kjo nga çfarë tregojnë provat materiale përgjatë gjykimit. Fillimisht, deklarata e të dëmtuarit M.R. e dhënë në Gjykatë konsiderojmë se është kontradiktore në deklarimet që i ka dhënë në Stacionin Policor e po ashtu deklarata e tij ishte kontradiktore në disa pjesë edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjatë shqyrtimit gjyqësor i njëjti deklaroi se i pandehuri Xh.Z. e ka kanosur me fjalët “ ti je m.., ty duhet me të vra” ndërsa në deklaratë e dt. 05.09.2023 të dhënë në Stacionin Policor i njëjti kishte deklaruar “ ti je m.., ty duhet me të vra se e meriton”. (nga këto deklarata shihet se i njëjti nuk i përshkruan saktë falët me të cilat pretendon se e ka kanosur i pandehuri). Po ashtu, gjatë deklarimit në shqyrtimin kryesor të dt. 20.08.2024 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, i dëmtuari ka deklaruar se pas finalëve që i pandehuri kinse i ka thënë të dëmtuarit, ky i fundit është larguar 1-1.5 metra, kurse në deklaratën e dt. 05.09.2023 të dhënë në Stacionin Policor i njëjti kishte deklaruar se pas këtyre fjalëve i njëjti ishte larguar e po ashtu edhe i pandehuri ishte larguar. Kjo pjesë e deklaratës si edhe shumë pjesë tjera kontradiktore mes tyre, duhet të jenë bazë e mjaftueshme për Gjykatën që deklaratën e tij të mos e marrin për bazë dhe një deklaratë të tillë Gjykata nuk duhet t’ia fal besimin. Nga këndvështrimi i aspektit objektiv të aktakuzës, gjegjësisht nga deklarata e të mbrojturit tim (të pandehurit) kuptohet qartësisht se veprimet e përshkruara nga i mbrojturi im, vërtetojnë faktin se atë ditë kanë pasur seancë në

Kuvendin e Komunës së Ferizajt dhe pas përfundimit të seancës duke dal jashtë te shkallët kishte vërejtur dy përfaqësues të Kuvendit B.O. dhe një tjetër që atë moment nuk i'u është kujtuar emri i tij dhe të cilët ishin duke biseduar me një person i cili është i një organizate jo Qeveritare dhe në atë moment kishte të ndërhyrë ky personi duke mos u prezantuar fare dhe duke i thënë “ Kryesues ti e ke shkel ligjin ", dhe se i pandehuri i'u ka drejtuar me fjalët se kush jeni ju dhe personi në fjalë prapë e kishte vazhduar duke i thënë ti e ke shkel ligjin që e ke dërguar A.G. drejtor në NLP " dhe se pala e pandehur i kishte thënë skam punë me ty dhe se nuk kishte biseduar asgjë tjetër me të dhe ishte larguar, duke mohuar kështu ta ketë kanosur me fjalë me përmbajtje kërcënuese siç janë përshkruar në dispozitivin e aktakuzës.

Po ashtu deklarata e të pandehurit shihet se është në përputhje edhe me deklaratimet e dëshmitarëve. Lidhur me këtë procedurë gjyqësore, në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar edhe dëshmitarët B.O., F.I. dhe Z.B.

B.O., në cilësi të dëshmitarit ka vërtetuar se në ditën kritike kur ka ndodhur rasti kanë qenë në seancën e ku seanca ka përfunduar rreth orës, dhe se kanë dalë jashtë në oborrin e komunës, dhe kur kanë dalë jashtë i njëjti ka filluar të bisedoj me kolegun asamblist F.I., aty ka qenë prezent edhe i pandehuri Xh.Z., ku kanë filluar disa pyetje nga i dëmtuari në këtë procedure M.R., duke i parashtruar pyetje Xh.Z/ se e ka punësuar A.G., një koleg të tij dhe pastaj ka filluar edhe Xh.Z. duke i thënë M.R. se kush je ti, dhe M. iu ka përgjigjur se është nga shoqëria civile dhe pastaj Xh.Z., i ka thënë një fjalë banale “ ti je m.. ", ku pastaj sipas dëshmitarit kanë vazhduar me kolegë dhe janë larguar nga aty. Sipas dëshmitarit, i njëjti me siguri të plotë ka deklaruar se pozita mes tij, M.R. dhe M.R. ka qenë e afërt dhe se i njëjti ka dëgjuar komplet bisedën mes tyre, duke mohuar faktin ta ketë dëgjuar Xh.Z. të i drejtohet M.R. me fjalët se i ka thënë “ty duhet me të vra ”.

Z.B. në cilësi të dëshmitarit ka vërtetuar se në ditën kritike kur ka ndodhur rasti kanë qenë në seancën e kuvendit komunal ku pas përfundimit të seancës kanë dalë jashtë në oborrin e komunës së bashku me Xh.Z. dhe shokët e tjerë asamblist, dhe kur kanë dalë jashtë tek shkallët e objektit të Komunës ka qenë edhe M.R. dhe se i kujtohet se M. ka kërkuar nga Xh.Z. diçka për çështje të ligjit, dhe ka kërkuar gjoja nga Xh.Z. se pse nuk e ka respektuar ligjin dhe procedurat ligjore të kuvendit për një çështje të caktuar, ku sipas dëshmitarit Xh.Z. fillimisht e ka pyetur se kush je ti që po kërkon sqarime dhe se i njëjti e ka përdorur një fjalës ofenduese dhe fjalë të tjera nuk ka pasur ku edhe janë larguar nga aty. Dëshmitari me bindje ka deklaruar se ka dëgjuar tërë bisedën mes Xh.Z. dhe M.R. pasi që ka qenë së bashku me ta dhe ka mohuar të ketë n dëgjuar se Xh.Z. iu ka drejtuar me fjalët “ ty duhet me të vra ”.

F.I. në cilësi të dëshmitarit ka vërtetuar se në ditën kritike kur ka ndodhur rasti kanë qenë në seancën e K.K. si shef i grupit parlamentar të-së, dhe pas përfundimit të seancës kanë dalë jashtë objektit të Komunës në oborr, dhe se aty jashtë ka qenë afër me Xh.Z. dhe se aty afër është afruar edhe M.R.. I njëjti ka deklaruar se ka dëgjuar bisedën mes Xh.Z. dhe M.R., dhe sipas tij biseda ka qenë diçka rreth krye shefit të ambientit që ka bërë shkelje, ku Xh. iu ka drejtuar me fjalët “se kush je ti” dhe se M.R. i’u ka përgjigjur se jam prej-së, ku Xh.Z. pastaj iu drejtuar me fjalë “ti je një m...”dhe nuk ka pas diçka tjetër. I pyetur dëshmitar a ka ndëgju që Xh.Z. ti ketë thënë M.R. “ ty duhet me të vra” , edhe ky mohon të ketë dëgjuar që i njëjti i ka përdorur këto fjalë.

Dëshmia e këtyre dëshmitarëve të cilët kanë qenë prezent në ditën e rastit të ndodhur, duhet të merret parasysh nga ana e Gjykatës përveç të tjerash edhe për faktin se të njëjtit i ka përmendur edhe i dëmtuari M.R., i cili ka deklaruar se në momentin kritik kur i njëjti pretendon të jetë kanosur nga ana e Xh.Z. kanë qenë pikërisht edhe këta persona prezentë ku si mbrojtje e të pandehurit nuk kemi hezitur ti propozojmë si dëshmitar ku të tre me fjalë të njëjta kanë mohuar të kenë dëgjuar që Xh.Z. në një moment të caktuar ta ketë kanosur M.R.me ndonjë fjalë.

Duke i pas parasysh të lartë cekurat, shihet se Prokuroria ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit Xh.Z. me vetëm një deklaratë të vetme dhe atë të dëmtuarit duke mos arritur që me asnjë provë tjetër të vërtetojë faktin se i pandehuri Xh.Z. ka kanosur të dëmtuarin. Andaj Gjykatës i propozojmë që lidhur me këtë lëndë, pas analizimit të të gjitha fakteve dhe provave të merr Aktgjykim Lirues ndaj të pandehurit Xh.Z.

I pandehuri Xh.Z. në fjalën përfundimtare deklaron se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim të dhënë në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar, po ashtu edhe të elaboruar me gojë, është e vërtetë se për veprën penale që akuzohem nuk e ndiej veten të fajshëm dhe në mungesë të provave propozoj Gjykatës që të shpall aktgjykim lirues.

Në shqyrtim gjyqësor të mbajtur me datën dhe vazhduar me datën gjykata ka administruar provat si në vijim: dëgjimin e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit M.R. dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga mbrojtësi i pandehurit Xh.Z., Av. Besmir Rrahmani, dëgjimi i dëshmitarëve B.O., F.I., Z.B., leximi i provave materiale: Raporti i Oficerit me numër të rastit i datës 05.09.2023; Deklarata e të pandehurit Xh.Z. e dhënë në polici, me datë; Deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit M.R. e dhënë në Polici me datë; Njoftim-Raportim nga Lëvizja për Demokraci e datës ...; Leximi i njoftimit i papranuar nga Drejtoria e

Administratës së Përgjithshme e Kuvendit Komunal në Ferizaj për sigurimin kamerave të sigurisë për datën rreth orës 12:00 h pranuar me datën 11.10. 2024, Shikimi i videos në shqyrtimin gjyqësor me datën 29.10.2024, që kishte propozuar pala e dëmtuar dhe pasi ka ber njoftimin se mundë të sigurohet nga jotube arkivës TV T..., ku është mundësuar të gjendet në jutube nga punëtori i IT të Gjykatës për shikim për datën që akuzohet i pandehuri se e ka kanosur ku është shikuar nga të gjitha palët prezentë si dhe shkresat tjera të cilat gjenden në lëndë.

I dëmtuari M.R. në cilësinë e dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se për rastin për të cilin po dëshmoj kam dhënë deklaratë në Stacionin Policor në Ferizaj, për rastin në fjalë më kujtohet se çka kam deklaruar ndoshta jo 100%, por i përmbahem në tërësi deklaratës që e kam dhënë. Data e rastit ka ndodhur më, pas përfundimit të seancës të K.K.. Unë kam punuar në një organizatë jo qeveritare “ L....per D....i ”, ku merren me monitorimin e punës së K.K., me monitorimin e konkurseve të punës dhe me çështjen e deklarimit të korrupsionit. Atë ditë në sallën e K.K. në Ferizaj kam qenë duke monitoruar punën e kuvendit komunal pasi që ka pas një seancë të rregullt, në sallë ka pas edhe organizata të tjera duke monitoruar por me emra nuk më kujtohet dhe në sallë kam qëndruar në pjesën ku është e caktuar për organizatat jo qeveritare. Atë ditë ne ishim duke monitoruar si organizatë një konkurs publik për kryeshef të ndërmarrjes publike NPL “.....”, ku në këtë ndërmarrje emërohet në zyrtar- asambleist i AAK-së (partisë politike), atëherë ne si organizatë kemi pranuar disa shkresa- emali, sepse kryeshefit A.G. është duke iu kurdisur konkursi dhe qëllimi im ishte që të marr një prononcim se a ka ndikuar kryetari i AAK-së dhe kryetari i K.K. në Ferizaj në atë konkurs. Pas mbarimit të seancës unë kam dal jashtë në oborr, kur kam dal jashtë kemi qenë duke biseduar me disa shokë që ishin aty por edhe me disa ansambleista për çështjen e kuvendit. Kur ka dal Xh.Z. nga kuvendi në oborr të komunës, unë kam dashtë të pyes se a je në dijeni se kryeshefi i ndërmarrjes “A.....” është emëruar në kundërshtim me ligjin, dhe i njëjti më është përgjigjur me një ton të lartë dhe me fjalë të rënda “ti je m..., ty duhet me të vra”, e nga këto fjalë unë jam shqetësuar shumë dhe jam larguar nga aty, e pasi jam larguar unë kam njoftuar rastin në polici , prokurorin dhe krye prokurorin. Në vazhdim në dëshminë e tij në pyetjet pashtuara nga prokurori i shtetit është përgjigjur se me me Xh.Z. jam takuar në vitin pasi që edhe unë isha në partinë e Xh.Z. dhe në atë kohë me te nuk kam pas problem por prej momentit kur kam dhënë dorëheqje nga kjo parti ka pas sjellje jo të mira ndaj meje, më ka fyer dhe pas këtij rasti me te nuk kam pas diçka të keqe por familjarët e tij djali i tij ka marrë veprime që të takohet me mua, më ka qua fjalë prej

njerëzve mos ja nxin për të madhe, ai tani është moshuar kanë dashtë me qetësua situatën.

Në pyetjet e parashtruar të dëmtuarit M.R. nga mbrojtësit të pandehurit Xh.Z., av. Besmir Rrahmani, është përgjigjur: *Pyetje:* në deklaratën e dhënë në polici në rreshtin 14 faqe 2, ndër të tjera keni deklaruar se “ Xh. filloj me një zë të lartë duke më thënë, kush je ti, unë iu përgjigja se kush jam...”, në bazë të kësaj deklarate në atë kohë i pandehuri a të ka dhënë përshtypjen që ti të ka njoft apo s’ të ka njoft fare? *Përgjigje:* ky më ka dhënë përshtypjen se kush jam por më ka pyetur si injorancë, unë iu kam përgjigjur se kush jam edhe pse më ka njoft.

Në pyetjet e parashtruar nga Gjykata, i dëmtuari deklaroi se pas këtij rasti kam qenë në K.K. në Ferizaj në rolin e kryetarit të sindikatës të punëtorëve KRM P....., por me Xh. nuk jam takuar, pas këtij rasti dhe nuk kamë pas kërcënime.

Dëshmitari B.O. në seancën e shqyrtimit gjyqësor në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi i të pandehurit Xh.Z., Av. Besmir Rrahmani, ka deklaruar se atë ditë siç më kujtohet me datë, kemi qenë në seancën e K.K. ku unë kam qenë pjesëmarrës në mbledhje pas përfundimit të mbledhjes kemi dal jashtë objektit të komunës, në oborr dhe kur kemi dal kemi fillua duke biseduar ka qenë shoku F. por edhe disa shokë tjerë ka qenë si kolegu Xh.Z. por ka qenë edhe M.R., dhe kanë filluar pyetjet nga personi që është prezent M.R. duke i parashtruar pyetje Xh.Z. se e ke punësuar A.G. një koleg tëndin, ku Xh.Z. i ka thënë M. se “ kush je ti “, dhe M. i ka thënë se “unë jam i shoqërisë civile” dhe pastaj Xh.Z. iu ka thënë ti je “ m... “, dhe pastaj kolegë jemi larguar nga aty. Unë me M. dhe Xh. kur kanë biseduar ato mes veti ka qenë pozitivë e afërt diku 4-5 metra, ku kam dëgjuar vetëm atë që e thash tjetër nuk kamë dëgjuar, unë jam larguar, nga aty se kush është larguar i pari nuk më kujtohet, pasi që unë isha duke biseduar me një koleg timin të partisë.

Dëshmitari Z.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datën, pas përfundimit të mbledhjes së K.K. diku rreth orës 12:00 h, kemi dal nga mbledhja, kemi dal nga ndërtesa ku kemi dal në oborrin e K....., dhe së bashku kemi dal me kryesuesin, që është në seancën gjyqësore prezent Xh.Z., dhe shokët e tjerë asambleist, por kur kemi dal në shkallët e objektit ka qenë edhe personi që është prezentë M.R. dhe më kujtohet se M. ka kërkuar nga kryesuesi diçka për çështje të ligjit pasi që M. ka qenë pjesëmarrës në mbledhjen e kuvendit Komunal, dhe ka kërkuar nga kryesuesi gjoja se pse nuk e ke respektuar ligjin dhe atë të procedurave ligjore të kuvendit, por Xh.Z., e kam dëgjuar që ka kërkuar nga M. duke e pyet se kush je ti që po kërkon sqarime, por e kam dëgjuar se M. i ka thënë se jam pjesëtar i shoqërisë civile, por e di që Xh. e ka përdorur një fjalë ofenduese kurse tjetër fjalë nuk ka pas

dhe së bashku ne me Xh. jemi larguar nga aty por nuk ka pas ndonjë kanosje ose diçka nuk ka pas.

Dëshmitari F.I. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datë 31.08.2023, ka marrë pjesë në mbledhjen e K.K. në Ferizaj pasi që unë jam shef i grupit parlamentar të partisë Pas përfundimit të mbledhjes kemi dal jashtë në oborr jashtë objektit dhe kur kemi dal jashtë kemi qenë afër me Xh.Z., por ka qenë edhe M.R. aty. Unë kamë dëgjua, bisedën që po flisnin Xh. me M. ku siç më kujtohet ka qenë biseda diçka për krye shefin e ambientit që keni bërë shkelje, ndërsa krye shefi iu ka drejtuar se kush je ti, ndërsa M. i është drejtuar se jam prej -së, pastaj kryesuesi ju ka drejtuar një fjalë ofenduese ti je një m..., dhe nuk ka pas diçka tjetër, kemi qenë bashkë krejt kolegë bashkë, por nuk kamë dëgjuar se Xh.Z. ju ka drejtuar M.R. me fjalët “ty duhet me të vra”, ka qenë çështje minutash, jemi larguar kemi shkuar në kafiteri, ndërsa Xh. nuk e di se ku ka shkuar nuk jam i sigurt a ka qenë me neve a jo.

I pandehuri Xh.Z. në shqyrtim gjyqësor në mbrojtjen e tij të paraqitur ka deklaruar se për ditën kritike për të cilën bëhet fjalë, Kuvendi i komunës ka pas seancë të rregullt plenare, seanca ka filluar diku në ora 10:00 ose 10:05, dhe ka përfunduar diku pas orës 11:30, aty diku para orës 12:00. Pas përfundimit të seancës kemi dal nga salla e kuvendit të komunës në sheshin e qytetit ose para ndërtesës së komunës, si zakonisht si dalin kolegët bisedojnë për rrjedhën e seancës, për temat që janë diskutuar lidhur me seancën, dhe në diskutim e sipër me kolegët asabmleist ose kolegët e komunës të cilët kanë qenë F.I., I.O. dhe Z.B. ofrohet personi të cilin ju e quani të dëmtuar e i cili është prezent dhe pa asnjë arsye dhe pa asnjë të drejtë më drejtohet mua me fjalën “ kryesues ti e ke shkel ligjin”, dhe unë i them se “ kush je ti ”, në kuptimin se kush je ti që më akuzon mua që unë e shkel ligjin dhe nga kush je i autorizuar të më thuash se unë kam shkel ligjin, por i njëjti vazhdon edhe dy apo tri herë të tjera duke mu drejtuar se “ ju e keni shkel ligjin”, dhe krejt kjo për arsye se unë e paskam shkel ligjin me rastin e zgjedhjes së drejtorit apo kryeshefit të ndërmarrjes publike “Ambienti ”, njoftoj Gjykatën se unë nuk kam pas të drejtë e as kompetencë që të zgjidhi drejtorin apo kryeshefin e ndërmarrjes publike “A. ”, po ashtu njoftoj Gjykatën se ndërmarrja publike është Institucion në vete e cila ka organet e veta të cilat marrin vendim për zgjedhjen e udhëheqësit të tyre. Pra ndërmarrja publike ka aksionarin e vet që është komuna, ka bordin të cilat janë përgjegjëse për zgjedhjen e udhëheqësit apo drejtorit të ndërmarrjes, dhe për zgjedhjen e drejtorit apo kryeshefit shpallet konkurs, me të cilin parashihen kriteret me të cilin duhet të plotësohen nga kandidati i cili aplikon për kryeshef, e nëse ato kritere shkelen përgjigjet komisioni

intervistues, bordi dhe aksionarët dhe në rastin konkret që pretendon zotëria se A.G. është zgjedhur kryeshef i Ndërmarrjes Publike Pastërtia, jashtë ligjshëm dhe ligjin e paska shkelur Xh.Z., e këtu nuk ekziston element i shkeljes së ligjit pasi që unë nuk jam as aksionar e as anëtar i bordit, e as nuk kam qenë anëtar i bordit të komisionit intervistues, e as nuk kam marrë pjesë në përzgjedhjen lidhur me punësimin e drejtorit, por personi që është në cilësinë e të dëmtuarit pretendon se unë kam zgjedhur drejtorin. Në akuzën që ma ka bërë mua se unë e kam shkelur ligjin, pyetja ime ka qenë “ *kush jeni ju* “, që kërkon llogari nga unë, se kinse a je organ i akuzës, organ hetues apo hulumtues, e përgjigja e tij ka qenë se unë jam ... dhe unë ia kam kthyer me përgjigjen time se ti je “ *m...* “, pa e kërcënuar, e asnjë fjalë tjetër nuk e kam folur. Unë nuk ju kanë drejtuar z. M.R. gjatë tërë kësaj bisede ndonjëherë me fjalën “ *ty duhet me të vra* ”, as mendja nuk më ka shkuar, pasi që nuk kam pas arsye, se kurrë nuk kam menduar e as sot nuk mendoj se duhet të vritet një person- një shqiptar, pasi që nuk më ka bërë asnjë gjë. Dhe pas takimit me te në dalje nga komuna kam vazhduar kam shkuar në kafiterinë F... dhe me plot kolegë të kuvendit kemi pirë kafe pa asnjë problem dhe pas këtij rasti nuk jam takuar me M.R. Në vazhdim në mbrojtjen e tij në pyetjet e parashtruara nga prokurori i shteti është përgjigjur se në kohën për të cilën po akuzohem kamë qenë kryesues i K.K. dhe atë ditë kemi pas mbledhje të kuvendit dhe gjatë mbajtjes së seancës në kuvend ka pas edhe monitorues nga ... por nuk ia di emrin organizatës, por M.R. ka qenë pjesëmarrës, edhe pse marrin pjesë ...-të gjatë seancës nuk mundën me diskutua. Pala që është prezentë seancën gjyqësore M.R. , edhe më herët e kam njohur sepse një kohë të shkurtër ka qenë anëtar i AAK-së dega në Ferizaj, kryetar i së cilës jam unë, por ka shumë vite që nuk e kam takuar dhe nuk kam pas asnjë raport as të mirë e as të keq. Në vazhdim të mbrojtjes së tij prokurori i shtetit i parashtron pyetje të pandehurit, *Pyetje*: pas përfundimit të seancës siç e pamë edhe në video, shihet se kur keni dal jashtë objektit të komunës, para hyrjes keni diskutuar me të dëmtuarin por nuk dëgjohet se çka, ke një moment shihet se dora juaj ishte në lëvizje çka nënkupton dora juaj? *Përgjigje*: kur e kam përfunduar fjalën unë e kam përdorur fjalën si çdoherë, edhe kam lëvizur dorën pa vëmendje, nuk e kam menduar se si e kam lëvizur. *Pyetje*: a keni pas ndonjëherë ndonjë mosmarrëveshje me të dëmtuarin? *Përgjigje*: jo asnjëherë dhe ka shumë vite që nuk e kam takuar. *Pyetje*: personat që ishin aty duke biseduar, a janë të partisë suaj? *Përgjigje*: jo janë të subjekteve të ndryshme politike. *Pyetje*: djemtë tuaj a kanë biseduar me të dëmtuarin për këtë temë, pasi që ka ndodhur kjo bisedë? *Përgjigje*: me dijeninë time jo.

I dëmtuari M.R. i parashtron pyetje të pandehurit Xh.Z. *Pyetje*: a është e vërtetë se mu

ke drejtuar me zë të lartë me fjalët “*se duhet me të vra* “ ? *Përgjigje*: nuk është e vërtetë se të kam thënë këtë fjalë.

Në vazhdim i pandehuri Xh.Z. në mbrojtjen e tij deklaron se un dua të shprehi brengën time të madhe dhe e ndiej veten shumë keq se si ka ardhur deri te një aktakuzë ndaj meje pa asnjë bazë, pa asnjë arsye, pa asnjë fakt, pa asnjë argument, dhe si organet e drejtësisë së shtetit tim më ftojnë mua në Gjykatë, ku unë në jetën tim kurrë nuk e kam menduar dhe nuk e kam imagjinuar që të më ftojnë pa asnjë bazë juridike, sikurse që janë organ shtetëror gjykata dhe prokuroria, ashtu është edhe kuvendi komunal të cilin unë e përfaqësojë dhe organi i prokurorisë bënë akuzë ndaj meje, pa më intervistuar, pa më ftuar, duke i besuar një qytetari të pa ndërgjegjshëm, pra tërë jetën time jam angazhuar në radhë të parë për liri pastaj për pavarësi e tash për ndërtimin e një shteti të drejtë demokratik të drejtë dhe ligjor, unë jam befasuar si organet e drejtësisë i besojnë një qytetari i cili merret me shpifje ndaj secilit institucion të shtetit dhe ta keni parasysh se si mund ta ndiej veten unë kur mua më quani të pandehur dhe personin e cili ka shpifur ta quani të pandehur, andaj për arsyet e lartë cekura nuk e diej veten të fajshëm.

Në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç ‘rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale në rastin konkret vlerëson se në mungesë të provave nuk është dëshmuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilat akuzohen, pasi që nuk është vërtetuar me ndonjë provë se i pandehuri datën për të cilën akuzohet se e ka kanosur të dëmtuarin me fjalët “*ty duhet me të vra*”, e vetmja provë që i lidhë të pandehurit me veprën penale që akuzohet është fjala “*ti je m...*” ku ketë nuk e mohon as i pandehuri por edhe as dëshmitarët në dëshminë e dhen në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata në rastin konkret pas trajtimit të hollësishëm të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit nenin 257 par. 1 dhe par. 2 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale nr.08/L-032) në të cilin është përcaktuar se: Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në

një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale” dhe Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm nënjë deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në policiose para prokurorit të shtetit , duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë si dhe dispozitat ligjore gjykata i ka liruar të pandehurit nga akuza.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin dëshmisë së të dëmtuarit – dëshmitarit M.R. pasi që deklarimi i tij ishte i saktë sa i përket asaj se ditën kritike ka shkuar në sallën e K.K. në Ferizaj, ka qenë duke monitoruar punën e kuvendit komunal pasi që ka pas një seancë të rregullt duke monitoruar si organizatë një konkurs publik për kryeshef të ndërmarrjes publike NPL dhe pas mbarimit të seancës gjyqësore i dëmtuari ka dal jashtë në oborr, kur ka dal jashtë ka qenë duke biseduar me disa shokë që ishin aty por edhe me disa ansableista për çështjen e kuvendit. Kur ka dal Xh.Z. nga Kuvendi në oborr të komunës, ka dashtë të pyes se a je në dijeni se kryeshefi i ndërmarrjes “.....” është emëruar në kundërshtim me ligjin, dhe i pandehuri i’u është përgjigjur me një ton të lartë dhe me fjalë të rënda “ ti je m..., ty duhet me të vra”, e nga këto fjalë i dëmtuari është shqetësuar shumë dhe është larguar r nga aty, mirëpo gjykata nuk ia fali besimin deklarimit të tij sa i përket pjesës se i pandehuri e ka kanosur me fjalët “ Ti duhet me të vra ”, pasi që nga dëgjimi i dëshmitarëve me asnjë dëshmi nuk vërtetohet se i pandehuri e ka kanosur të dëmtuarin me fjalët e lart cekura pos fjalëve të ndytuara se “ ti je m...” ku ket e vërtetoj edhe nga deponimi dëshmive të dëshmitarëve të dhënë në shqyrtimin gjyqësor por edhe nga vet pandehuri.

I dëmtuar M.R. në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 01.10.2024 ka propozuar që nga Gjykata të sigurohet nga kamera e sigurisë të objektit të K. në Ferizaj për datën 31.08.2023 që të shihet incizimi ku gjykata ka aprovuar propozimin e tij dhe i ka bërë kërkesë D.A. së Komunës në Ferizaj që të na sigurohet kamera e vendosur jashtë objektit të komunës që për datën 31.08.2023 rreth orës 12:00h kur jan takuar i pandehur dhe i dëmtuari në oborrin e objektit të komunës , ku Gjykata me datën 10.11.2024 ka pranuar Njoftimin nga Drejtoria për A.P. ,ku na kanë njoftuar se Stacioni Policor në Ferizaj pasi që kamerat përreth objektit të komunës në Ferizaj i mbikëqyren ngas Policia. Por pas njoftimit të të dëmtuarit lidhur me arsyet e mos sigurimit të kamerave i njëjti e njofton gjykatën se kjo mundë të sigurohet edhe nga Nju tube ku kemi ftuar edhe punëtorin e IT të Gjykatës ku në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor është siguruar shikimi, por pas shikimit të videos që është në Njutube nuk dëgjohet zëri pos shqimit se i pandehuri kishte drejtuar duart në drejtim horizontale jo larë kah i

dëmtuari dhe nga kjo nuk mundë të dëgjohet se a e ka kanosur të dëmtuarin me fjalët me të cilat akuzohet i pandehuri. Gjykata ia fali besimin e plotë mbrojtjes së të pandehurit të dhënë në shqyrtim gjyqësor pasi që e njëjta ishte në përputhje me provat e tjera të administruara e sidomos me dëshminë e dëshmitarëve Z.B., B.O., F.I.

Rrjedhimisht, gjykata në rastin konkret ka zbatuar edhe dispozitat e nenit 3 të KPP-së, përkatësisht parimin “ in dubio pro reo”, ku në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”. Neni 20 i KPRK-së (Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës) përcakton se: “*Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore*”. Në këtë çështje penalo-juridike nuk është arritur të provohet përtej dyshimit të bazuar mirë se me cilat fjalë apo veprime i pandehuri e ka kanosur palën e dëmtuar.

Për me tepër, gjykata në rastin konkret, ka zbatuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës përkatësisht dispozitën e nenit 31 par. 5, me të cilin garantohet e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në të cilën dispozitë është përcaktuar se “ Çdokush i akuzuar për vepër penale, prozhmohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij në pajtim me ligjin”, e cila dispozitë ndërlidh Liritë Themelore, ku në pikën 2 është përcaktuar se “ Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.

Gjykata gjatë zbatimit të këtyre dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nenit 31 par 5, Konventës Evropiane Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore Nenit 6 par. 2 si dhe nenit 3 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme të cilat vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihen në barrë Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe në bazë të nenin dhe 363 par. 1 pika 1.3 të KPP-së e liroi të pandehurin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye se në rastin konkret, nuk është provuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale.

Në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPPRK-së, gjykata vendosi që e dëmtuara të udhëzohet në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Në bazë nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, i pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, ndërsa të njëjtat shpenzime do të paguhet nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,
P.nr. P.nr. 2023:238451, me datë 22.11.2024

Zyrtare ligjore
Arbelinda Tahiri

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.